



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 102, Datë 04.07.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN
GREEN ENERGY” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1 gërma “d”; 10, pikat 3, 6 dhe 7 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” e “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

ERE me Vendimin nr. 68, datë 11.05.2017, vendosi mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, duke qënë se u konstatua mungesë e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e pagesës së aplikimit për paisje me licencën e furnizimit të energjisë elektrike.

ERE më shkresën nr. 352/2 Prot., datë. 22.05.2017, njoftoi subjektin “Albanian Green Energy” sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 059 Prot., datë 06.06.2017, paraqiti në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10 pika 7, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikim, Transferim, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, dokumentacionin e munguar për të plotësuar aplikimin e tij, si dhe kreu pagesën e aplikimit për paisjen me licencë furnizimi me energji elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI